

TRANSKRIPTI PËR 16 DITË TË AKTIVIZMIT PËR NDALIMIN E DHUNËS NË BAZA GJINORE

Radio Ophelia, 107.2 FM Pristina and 106.5 FM Mitrovica

Narrator Mr. Shpend Berbatovci

UN Women representatives: Ms. Nicola Brassil [Voice-over Ms. Rrita Qena] and Ms. Isabelle Jost [Voice-over Ms. Florina Katrati]

[NARRATOR]

Kudo, në shtëpi, në rrugë apo gjatë luftës, dhuna ndaj grave është PANDEMI GLOBALE që ndodh në hapësira PUBLIKE e PRIVATE.

Çdo vit mes 25 nëntorit dhe 10 dhjetorit anembanë botës shënohen 16 Ditët e Aktivizmit për Fund të Dhunës në Baza Gjinore. Isabelle Jost dhe Nicola Brassil nga UN Women në Kosovë do të na tregojnë më shumë për situatën aktuale rreth dhunës ndaj grave dhe vajzave në Kosovë.

[NARRATOR]

Për fillim, a mund të na tregoni cilat janë format e dhunës në baza gjinore?

[Nicola Brassil, UN WOMEN]

Dhuna në baza gjinore mund të jetë e formës fizike, seksuale dhe psikologjile. 1 në 3 gra anembanë botës kanë përjetuar dhunë fizike apo seksuale në të shumtën e rasteve nga ana e partnerit të afërm. Pothuajse një në katër vajza adoleshente kanë qenë viktima të dhunës fizike.

[NARRATOR]

E sa i përket Kosovës, si është situata aktuale këtu?

[Nicola Brassil, UN WOMEN]

Më 2014, gati 1,200 raste të dhunës familjare ishin raportuar në Policinë e Kosovës. 79% e viktimave ishin femra, kurse 95% e autorëve ishin meshkuj.

[Isabelle Jost, UN WOMEN]

Një studim i ri tregon se rreth 42% e femrave dhe 22% e meshkujve në Kosovë besojnë se bashkëshorti ka të drejtë ta rrahë gruan në rrethana të caktuara. Kjo shifër është edhe më e lartë tek pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas ku 74% e femrave dhe 37% e meshkujve e arsyetojnë dhunën e tillë.

[NARRATOR]

Cilat janë arsyet pse gratë dhe vajzat janë më shpesh viktima të dhunës familjare?

[Nicola Brassil, UN WOMEN]

Ekzistojnë shumë arsye pse dikush mund të bëhet viktimë e dhunës në baza gjinore. Për shembull ekspozimi ndaj situatave të dhunshme, qasje e mangët në arsim apo abuzimi me alkool apo droga tjera mund të rrisë

mundësinë e shëndërrimit në autorë apo viktime të dhunës. Sidoqoftë, arsyeja kryesore pse gratë dhe vajzat preken më shumë nga dhuna është mbizotërimi i pabarazisë gjinore në shoqëri.

[Isabelle Jost, UN WOMEN]

Do të doja të shtoja se kjo pabarazi mund të vërehet në Kosovë si dhe në vende të ndryshme të botës, siç është përfaqësimi jo i barabartë i grave në politikë apo pjesëmarrja më e ulët e grave në ekonomi. Kështu që një prej mënyrave të luftimit të dhunës në baza gjinore është fuqizimi i grave përmes rritjes së pjesëmarrjes politike dhe fuqizimit ekonomik.

[NARRATOR]

Si qëndron përfaqësimi i grave në politikë në Kosovë?

[Nicola Brassil, UN WOMEN]

Më 2015, pjesërisht falë kuotës, një e treta e deputetëve të Kosovës janë gra. Sidoqoftë, vetëm 1 prej 38 kryetarëve të komunave në Kosovë është grua. Prej 21 ministrave në Kosovë, vetëm dy janë gra. Ky mund të jetë pjesërisht rezultat i perceptimit të popullit të Kosovës se kush është lider më i mirë politik.

[Isabelle Jost, UN WOMEN]

Po, keni të drejtë. Studimet tregojnë se në Kosovë 45% e njerëzve mendojnë se burrat janë liderë më të mirë politik se sa gratë dhe vetëm 34% mendojnë se në përgjithësi, gratë dhe burrat janë njejtë liderë të mirë politik.

[NARRATOR]

E sa ju përket institucioneve të sigurisë në Kosovë? Sa janë të përfaqësuara gratë aty?

[Nicola Brassil, UN WOMEN]

Gratë përbëjnë 15% të Policisë së Kosovës dhe 8% të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

[NARRATOR]

E kur flasim për ekonomi, si qëndrojnë gratë në atë aspekt?

[Isabelle Jost, UN WOMEN]

Në Kosovë shkalla e papunësisë për gra është rreth 42 % dhe marrin pjesë në tregun e punës me rreth 21 %, që do të thotë se vetëm 21% e grave të moshës së punës ose janë të punësuara ose aktivisht kërkojnë punë. Kjo tregon se shumë gra janë ekonomikisht të varura nga bashkëshortët apo familjet e tyre. Në rastet e dhunës familjare kjo e bën tejet të vështirë që ato të i braktisin situatat e dhunshme.

[NARRATOR]

Për të kuptuar si mund të ndihmoni në ndaljen e dhunës në baza gjinore dhe për të ju bashkuar fushatës 16 Ditë të Aktivizmit vizitoni faqen www.16-dite.com apo në Facebook faqen **16 Days - No Violence**.

Bëhuni pjesë e ndryshimit në komunitetin e juaj!